

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“EKOSERV” SH.P.K.**

Sot, më datën 16.02.2023, **Z. Rudin Taullai** i lindur në Durres , më datë 21 Qershor 1975 mbajtës i leternjoftimit elektronik me numër personal 037061183 banues në Durres, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**EKOSERV**” Sh. P. K. si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personi fizikë i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin “**EKOSERV**” shpk.

Ortak i kësaj shoqërie është **Z. Rudin Taullai**

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Rudin Taullai** .

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “**EKOSERV**” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh.P.K.**”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “**EKOSERV**” SH.P.K. është: DURRES Lagjja nr. 11, Rruga Prokop Meksi, Pallati nr. 871, Shkalla nr. 2, Ap. 27 *Neni 8*

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Transportin ,grumbullimin ,magazinimin ,trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve te rrezikshme dhe /ose jo te rrezikshme, perfshire operacione riciklimi dhe rekuperimi dhe shkembim mbetjesh te rrezikshme dhe /ose jo te rrezikshme per t'ia neneshtuar operacioneve te meparshme te rekuperimit si para-trajtimi, ndarja, fragmentizimi,ngjeshja, paletizimi,tharja,grirja, kondensimi ,seleksionimi dhe grupimi.
- Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjetër komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise.

**Neni 5**



Kapitali i shoqërise është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërise ndahet në një numër kuotaesh në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuota të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

**Z. Rudin Taullai** zotëruar i një kuotaesh me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërise përkundëjt të treqëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të treqë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

*Rudin Taullai*  
**Rudin Taullai**



**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“EKOSERV” SH.P.K.**

**KREU I**

**Dispozita të Përgjithshme**

*Neni 1*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “EKOSERV” Sh. P. K. është krijuar nga data 16.02.2023 nga ortaku i saj **Z. Rudin Taullai**.

*Neni 2*

Emërtimi i shoqërisë është “EKOSERV” SH.P.K..

*Neni 3*

Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti krijohet me mjete private të themeluesit të saj.

*Neni 4*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “EKOSERV” SH.P.K , në përputhje me krijimin e kësaj shoqërie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.

*Neni 5*

Shoqëria “EKOSERV” SH.P.K.. është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit në organet përkatëse. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj, kontratën dhe në këtë statut.

*Neni 6*

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Transportin ,grumbullimin ,magazinimin ,trajtimin dhe asgjесimin e mbetjeve te rrezikshme dhe /ose jo te rrezikshme, perfshire operacione riciklimi dhe rekuperimi dhe shkembim mbetjesh te rrezikshme dhe /ose jo te rrezikshme per t'ia neneshtuar operacioneve te meparshme te rekuperimit si para-trajtimi, ndarja,fragmentizimi,ngjeshja, paletizimi,tharja,grirja, kondensimi ,rikondensimi,seleksionimi dhe grupimi.
- Gjithashtu, shoqëria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise.

*Neni 7*

Selia e shoqërisë “EKOSERV” SH.P.K. është: DURRES Lagjja nr. 11, Rruga Prokop Mexsi, Pallati nr. 871, Shkalla nr. 2, Ap. 27



#### *Neni 8*

Shoqëria ushtron veprimtarinë e vet të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprimtarie shoqëria mund të çelë degë, filiale dhe zyra të saja të përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

#### *Neni 9*

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.

#### *Neni 10*

Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera e për të drejta të tjera pronësie.

Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tek kapitali themeltar.

#### *Neni 11*

Të drejta kryesore të ortakëve janë:

- Pjesëmarrja në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë më përputhje me kontratën dhe statutin e vet ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.
- Pjesëmarrja në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në çdo formë dhe sasi qoftë në përputhje me statutin dhe kontratën.
- Pjesëmarrja në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të kërkojë t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentet e përpunuara të shoqërisë si bilanci, llogaritë ekonomike etj.
- Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
- Të emerojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

#### *Neni 12*

Detyrimet e ortakëve janë:

- Pjesëmarrje në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tij, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijon ai.
- T'i japë shoqërisë informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.



## KREU II

### Kapitali i Regjistruar

#### *Neni 13*

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabël dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

#### *Neni 14*

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuota të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

**Z. Rudin Taullai** zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrajt të treta deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### *Neni 15*

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj, ortaket e shoqërisë kanë të drejtën e rritjes në mënyrë proporcionale.

#### *Neni 16*

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve. Transferimi duhet të vërtetohet me akt noterial.

#### *Neni 17*

Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen. Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejtën e tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci dhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

#### *Neni 18*

Shoqëria krijon fonde rezervë ose fonde të tjera të veçanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj. Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondet rezervë, fondet e tjera ose nga shumatat themeltare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakut të vetëm, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

## KREU III

### Viti Financiar, Llogaritë Vjetore, Ndarja e Fitimit

#### *Neni 19*

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht viti i parë financiar ka filluar në ditën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon më 31 Dhjetor të atij viti.



*Neni 20*

Pasqyrat Financiare vjetore të shoqërisë deklarohen brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

*Neni 21*

Ortakët e përballojnë vetë humbjen e veprimtarisë së shoqërisë në të ardhmen.

*Neni 22*

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga ortaku i shoqërisë. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar.

*Neni 23*

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve si dhe fondet e lëna për rezervë për nxitje ekonomike, për investime, për reklamën tregtare etj e përfiton 100% ortakët e shoqërisë.

**KREU IV**

**Administrimi**

*Neni 24*

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë sipas kërkesave të nenit 82, pika 2 e ligjit nr. 9901. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë vendos për çështje të tilla si ndryshimi i statutit, zmadhimi, zvogëlimi dhe transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar, shndërrimin e shoqërisë nga Sh. P. K. në forma të tjera si dhe mbyllje të shoqërisë sipas kërkesave të ligjit Nr. 9901.

*Neni 25*

Administrimi i shoqërisë bëhet nga administratori.

- Asambleja e Përgjithshme cakton administratorin për një periudhë 5 (pesë) vjeçare sipas parashikimeve të shkronjës 'c' të pikës 1 të nenit 81 dhe të nenit 95 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "**Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare**". Emërimi do të jetë individual dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.
- Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit Nr. 9901, "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**".
- **Z. RUDIN TAULLAI** caktohet si administrator i shoqërisë për një periudhë prej 5 vjet, me të drejtë riemërimi.

*Neni 26*

Kompetencat e Administratorit janë:

- Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë.



- Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblesë, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar.
- Miratimi i akteve normative që përcaktojnë raportet e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë
- Krijimi i organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Propozimi në mbledhjet e asamblesë për krijimin e njësive, strukturave, filialeve, degëve dhe përfaqësive në qytet të tjera të vendit apo jashtë shtetit.
- Përzgjedhja e Ekspertit Kontabël dhe anëtarëve të komisionit të likuidimit dhe paraqitja e propozimeve për miratim në asamble.

## **KREU V**

### **Prishja dhe Njoftimet**

#### *Neni 27*

Kontrolli i shoqërisë mund të kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga ortakët e shoqërisë. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, ose kur bëhet e pamundur kryerja e detyrave.

#### *Neni 28*

Në rast likuidimi të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe Vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

## **KREU VI**

### **Dispozita të fundit**

#### *Neni 29*

Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të mbahen në një libër të veçantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

## **ORTAKU I SHOQERISE**

*Rudin Taullai*  
**Rudin Taullai**

